

A photograph of three microphones, with two being held by hands. The image is overlaid with a green-to-yellow gradient and a dark blue triangle in the top-left corner containing a white dotted pattern.

RAPORTI I MONITORIMIT TË GJUHËS SË URREJTJES NË KOSOVË

2025

—
VLORA KONUSHEVCI

Autore: Vlora Konushevc

Redaktor i metodologjisë: Stefan Janjić

Botuar nga: Kosovo 2.0 dhe Media Diversity Institute Western Balkans



K2.0



Rrjeti i Raportimit të Diversitetit (RDN) është themeluar nga Media Diversity Institute. Partnerët e projektit përfshijnë Media Diversity Institute Western Balkans, Albanian Women in Audiovisual, Mediacentar Sarajevo, Kosovo 2.0, Center for Investigative Journalism Montenegro, Innovative Media.



Ky publikim financohet nga Bashkimi Evropian dhe projekti rajonal “SMART Balkans – Shoqëri Civile për një Shoqëri të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor”, i zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Center for Research and Policy Making (CRPM) dhe Institute for Democracy and Mediation (IDM), dhe mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA), Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Center for Research and Policy Making (CRPM) apo Institute for Democracy and Mediation (IDM).



Reporting
Diversity
Network

RAPORTI I MONITORIMIT TË GJUHËS SË URREJTJES NË KOSOVË 2025

VLORA KONUSHEVCI

Përmbajtje

5	Hyrje
6	Qasja metodologjike
7	Analiza sasiore e narrativave të urrejtjes dhe dezinformimit
7	Caqet e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit
7	Llojet e autorëve
8	Platformat dhe mediat
8	Shpërndarja e analizës së sentimentit
9	Analiza e narrativave dhe nën-narrativave
9	Polarizimi etno-fetar: apostazia, konvertimi dhe "armiku brenda"
10	Urrejtja gjinore dhe mizogjinia
11	Fajësimi gjeopolitik dhe identiteti fetar
11	Analiza e sentimentit
12	Retorika religjioze dhe mospajtimi simbolik
14	Figurat publike dhe të famshmit - Nivelet 3 dhe 5
15	Nivelet 4-5: Dhuna me bazë gjinore dhe diskursi publik
17	Analiza e vizibilitetit
18	Analiza krahasimore
19	Veprimet parandaluese dhe ex-post për të luftuar urrejtjen dhe narrativat dezinformuese
20	Përfundim

Hyrje

Ky raport është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë rajonale për të dokumentuar dhe analizuar gjuhën e urrejtjes dhe narrativat diskriminuese në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë në Kosovë gjatë periudhës 1 janar 2024 – 30 qershor 2025.

Gjatë kësaj periudhe Kosova vazhdoi të lëvizte në një realitet të pasluftës të formësuar nga marrëdhëniet e brishta ndëretnike, paqëndrueshmëria politike dhe ndikimi i shtuar i mediave digjitale. Në këtë sfond, ky raport synon të analizojë narrativat e urrejtjes dhe dezinformimit që u shfaqën në mediat online dhe ato tradicionale, me fokus të veçantë në atë se si u targetuan dhe formësuan grupet e cënueshme dhe diskursi publik.

Raporti i Freedom House [Freedom in the World 2025](#) e vlerëson statusin e Kosovës si *pjesërisht e lirë*. Në anën tjetër, [Reporterët pa Kufij](#) e rendisin Kosovën në vendin e 99të, një rënie e ashpër prej 24 vendesh në *Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit 2025* nga pozita e 75të në vitin 2024, duke shënuar renditjen më të keqe të vendit deri më tani në rajon. Mes kushtesh të tilla, gjuha e urrejtjes, keqinformimi dhe fushatat e koordinuara, veçanërisht në mediat sociale, vazhdojnë të sfidojnë diskursin demokratik dhe kohezionin shoqëror.

Qenësore në këtë raport është njohja se gjuha e urrejtjes nuk ndodh në vakum. Ajo rrjedh, dhe mbështet tensione më të gjera shoqërore, politike dhe historike. Periudha e trajtuar u shënuar nga paqëndrueshmëria politike, duke përfshirë krizën e vazhdueshme institucionale në komunat veriore të Kosovës pas zgjedhjeve lokale të vitit 2024 si dhe një proces të ngecur të normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë në vazhden e ngecjes diplomatike. Në të njëjtën kohë, pikat e reja të nxehta kulturore dhe ideologjike, siç është shfaqja e Lëvizjes së Deçanit që mbron konvertimin fetar në katolicizëm, reagimi kundër kosovarëve që kryejnë haxhin (pelegrinazhi vjetor islam në Mekë) dhe debatet polarizuese rreth Kodit Civil dhe të drejtat LGBTIQ+, kanë intensifikuar vijat e çarjes/ndarjes të bazuara në identitetet. Këto zhvillime, së bashku me besimin e zbehur në institucione dhe diskursin publik të polarizuar, krijuan terren pjellor për gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin. Së këndejmi, ky raport merr një qasje sociologjike karshi gjuhës së urrejtjes që tejkalon përkufizimet e ngushta ligjore dhe shqyrton një spektër të larmishëm identitetesh personale dhe grupe.



Qasja metodologjike

Raporti ndjek parimet metodologjike të përcaktuara në fazën e mëparshme të monitorimit të *RDN*-së. Ai kombinon metodat sasiore dhe cilësore për të analizuar diskursin e urrejtjes dhe dezinformimit (HDD) në Kosovë gjatë periudhës 2024-2025.

Në aspektin sasior, hulumtimi bazohet në 114 incidente mediale të shënuara në një format të strukturuar monitorimi, duke përfshirë metadata si data e publikimit, platforma e burimit, rezultati i sentimentit dhe kategorizimi i grupeve të targetuara. Në aspektin cilësor është analizuar struktura narrative, nxitësit kontekstualë, gjuha simbolike dhe kornizimi më i gjerë shoqëror i mesazheve të urrejtjes.

Ky studim synon të thellojë të kuptuarit e diskursit të urrejtjes dhe dezinformimit (HDD) në Kosovë duke identifikuar modelet e përsëritura, nxitësit e mesazheve dhe mekanizmat simbolikë dhe emocionalë që qëndrojnë pas narrativave të tilla. Raporti hulumton burimet dhe platformat kryesore ku prodhohet urrejtja dhe dezinformimi, idetë dhe grupet që ata i targetojnë dhe përgjigjet sociale që provokojnë.

Për qëllime analitike, të gjitha incidentet e regjistruara u kategorizuan sipas shkallës së gjuhës së urrejtjes të Universitetit George Washington¹, e cila sillet nga mospajtimi retorik deri te thirrjet e qarta për vdekje:

- 1. Mospajtimi** – Retorika sfidon idetë ose besimet pa sulme personale.
- 2. Veprimet negative** – Retorika që shoqëron grupin me sjellje ose veprime të padëshirueshme.
- 3. Karakteri negativ** – Fyerje jo të dhunshme, shpifje ose sulme të karakterit.
- 4. Demonizimi dhe dehumanizimi** – Paraqitje e grupit si nënjerëzor, monstruoz ose i keq.
- 5. Nxitja e dhunës** – Thirrje ose justifikim të dëmtimit fizik.
- 6. Vdekja** – Dëshirë e qartë ose justifikim i vrasjes ose eliminimit të një grupi.

1. Bahador Babak et al. (2019), *Monitoring Hate Speech in the US*, George Washington University.

Analiza sasimore e narrativave të urrejtjes dhe dezinformimit

Mes viteve 2024-2025, në Kosovë u dokumentuan gjithsej 114 incidente të urrejtjes ose dezinformimit. Këto incidente përfshijnë grupe të targetuara, platforma mediale dhe profile të ndryshme të autorëve. Të dhënat zbulojnë këto trende kryesore:


Caqet e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit

Grupi më shpesh i targetuar ishte i bazuar në përkatësinë etnike, ku 27 incidente përfshinin ksenofobinë, diskriminimin etnik ose racizmin. Urrejtja me bazë gjinore doli në 22 incidente, ndërsa gazetarët ishin grupi i tretë më i targetuar (14 incidente), gjë që dëshmon cënueshmërinë e aktorëve medialë në diskursin publik.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kategoritë kryesore të urrejtjes, duke theksuar gjithashtu praninë e jotolerancës fetare (14 raste), homofobisë (12 raste) dhe incidenteve komplekse me shumë shtresa që kombinojnë disa kategori.


Megjithëse secili rast u kodua brenda kategorisë dominuese, disa incidente shfaqën forma të mbivendosura të diskriminimit, ta zëmë, duke kombinuar mizogjininë me homofobinë ose nacionalizmin me urrejtjen fetare. Këto kryqëzime u vunë re por u shpërndanë në kategoritë e tyre primare të targetuara për hir të qartësisë dhe konsistencës.

Figura 1. Numri i incidenteve të gjuhës së urrejtjes sipas llojit



Llojet e autorëve


Personat privatë ishin autorët më të shpeshtë, përgjegjës për mbi 42% të të gjitha incidenteve (50 raste). Ata ndiqen nga aktorët politikë (20 raste) dhe punëtorët medialë ose gazetarët (15 raste). Në shumë raste, narrativat e urrejtjes përfshinin aktorë hibridë (p.sh., politikanë + gazetarë), duke turbulluar kështu vijën mes komunikimit institucional dhe personal.

Figura 2. Autorët kryesorë të incidenteve të urrejtjes/dezinformimit

Platformat dhe mediat

Mediat sociale, sidomos Facebooku, ishin mediumi dominues për përhapjen e urrejtjes, të implikuara në mbi 76 incidente, ose si platformë e vetme ose si e përbashkët. Pas tyre vijnë portalet online (shpesh duke cituar burime të paverifikuara ose duke publikuar tituj mashtrues), me mbivendosje të shpeshta në platforma të shumta duke përfshirë platformat si YouTube, Telegram dhe X (Twitter).

Siç paraqitet në grafikun në vijim, përqendrimi i platformës flet për nevojën për ndërhyrje të synuara në Facebook dhe ekosistemi i mediave lokale brenda tij.



Shpërndarja e analizës së sentimentit

Shumica e incidenteve u karakterizuan nga sulme negative të karakterit (78 raste), shpesh duke përfshirë shpifje, etiketa delegjitimuese dhe krahasime dehumanizuese. Një pjesë më e vogël, por e rëndësishme, përfshinte thirrje për dhunë (15 raste) dhe veprime negative (16 raste), duke reflektuar momente të armiqësisë së shtuar.

Analiza e narrativave dhe nën-narrativave

Diskursi i urrejtjes dhe dezinformimit në Kosovë gjatë periudhës së monitorimit (janar 2024 – qershor 2025) u përqendrua në narrativa rezonante kulturore që mobilizuan ndarjet fetare, etnike dhe gjinore. Këto narrativa nuk ishin statike; ato intensifikoheshin në prag të ngjarjeve specifike si festat kombëtare, përvjetorët e incidenteve të lidhura me luftën, tensionet politike me Serbinë, shpërthimi i konfliktit të Gazës dhe debatet e vazhdueshme mbi rolin e fesë në jetën publike. Përsëritja e tyre flet për natyrën e vazhdueshme dhe reaktive të gjuhës së urrejtjes, të formësuar shpesh nga klima politike e përforcuar përmes ekosistemeve të mediave sociale.

Polarizimi etno-fetar: apostazia, konvertimi dhe "armiku brenda"

Një nën-narrativë e dukshme gjatë periudhës së monitorimit 2024 ishte poshtërimi i atyre që sfidojnë përkatësitë fetare dominuese përmes konvertimit ose heqjes dorë. Këto shprehje të mospajtitimit fetar, siç janë individët që konvertohen nga islami në katolicizëm ose përqafojnë ateizmin, shkaktuan reagime të forta si nga figurat klerike ashtu edhe nga segmentet e publikut, duke zbuluar ankthe të thella rreth kohezionit dhe identitetit kombëtar.

Kjo narrativë doli në pah në prill të vitit 2025, kur Arbër Gashi, anëtar i Lëvizjes së Deçanit, lavdëroi publikisht konvertimin e familjes Rugova në katolicizëm. Në një postim në X (ish-Twitter), Gashi e përshkroi ngjarjen si:

“Fitorja më e madhe e shqiptarëve në shekullin XXI”

Ky kornizim festiv i konvertimit fetar provokoi reagim të ashpër nga imami Osman Musliu i Xhamisë së Drenasit. Në një koment të postuar online, imami e sulmoi edhe Gashin edhe Lëvizjen që ai përfaqëson, duke shkruar:

“Kjo 'LEVIZJE e DREQIT' edhe ajo e vehabizmit-extremizmit janë 'FITORJA' ma e madhe e serbis e gjithë atyre armiqëve Lindje e Perendim qe nuk ua deshirojn te miren shqiptarëve dhe trojeve tona ju jeni klysh te atyre qe mundohen çdo ditë me shkatrrua Kosoven dhe Shqiptarin ... OOOO mjeran mos me te thanë coftinë!”

Kjo retorikë përzien ndëshkimin fetar me akuzat për tradhti, duke e cilësuar aktin e konvertimit si tradhti të besimit dhe kombit. Ajo i pozicionon figurat si Gashi, e së këndejmi edhe Lëvizjen e Deçanit, si armiq të brendshëm që punojnë për të fragmentuar unitetin shqiptar, duke i përafëruar ato në mënyrë retorike me ekstremizmin vehabist, një rrymë tjetër fetare shpesh e stigmatizuar në diskursin e Kosovës.

Ajo që është e rëndësishme këtu është shkrirja e fesë, nacionalizmit dhe pastërtisë kulturore, ku braktisja e islamit nuk është kornizuar si udhëtim personal shpirtëror, por si sulm ndaj trungut kolektiv të kombit. Akuzat se konvertime të tilla u shërbejnë interesave të Serbisë prek trauma dhe dyshime të gjata të pasluftës, duke intensifikuar efektin polarizues të mesazhit.

Ky shembull tregon se si gjuha e urrejtjes në Kosovë shpesh i tejkalon mosmarrëveshjet doktrinare dhe shndërrohet në territor biopolitik, duke etiketuar kategori të tëra individësh si të padenjë për përkatësi për shkak të besimeve, përkatësive ose besnikërive të tyre të perceptuara. Në këtë rast, konvertimi nuk portretizohet si liri e ndërgjegjes, por si kërcënim qytetëror. Gjuha e përdorur: "këlyshët", "lëvizja e dreqit", "coftinë", i dehumanizon caqet dhe i përforcon kufijtë përjashtues rreth identitetit fetar dhe kombëtar.

Urrejtja gjinore dhe mizogjinia

Periodua e monitorimit 2024–2025 zbuloi gjuhën e urrejtjes gjinore të ngulitur dhe të targetuar në ekosistemin medial të Kosovës. Gratë në jetën publike, sidomos ato në politikë, aktivizëm dhe komunitetin LGBTQ+, ishin cak i kallëpeve të ngacmimit që shtriheshin përtej sulmeve personale. Këto rrëfime u ngulitën në një përpjekje më të gjerë për t'i përjashtuar gratë nga struktura simbolike dhe politike e kombit.

Shpesh, gjuha e urrejtjes ndaj grave funksiononte jo vetëm si mizogjini, por si një mekanizëm policor i identitetit kombëtar dhe moral, duke sugjeruar se gratë që flasin, që sfidojnë normat ose që zënë dukshëm hapësirë publike po dalin jashtë kufijve të përkatësisë së pranuar. Një shembull i rëndë përfshin Vlora Çitakun, nënkryetare e Partisë Demokratike të Kosovës, e cila iu ekspozua një breshërie komentesh mizogjene në Facebook pas një deklarate politike. Një komentues shkroi:

“Kurve shpiunave te panit”²

Kjo shpifje kombinon delegitimimin politik (etiketimin e saj si pjesë e koalicionit të diskredituar PAN) me gjuhën e urrejtjes së seksualizuar. Ky është një sulm i qëllimshëm jo vetëm ndaj gjinisë së saj, por edhe ndaj legjitimitetit të saj politik dhe besnikërisë ndaj kombit, duke nënkuptuar se ajo u shërben armiqve të huaj ose të brendshëm.

Një rast tjetër përfshiu Zana Avdiun, aktiviste civile që doli në një debat televiziv. Pjesëmarrja e saj shkaktoi një vorbull të urrejtjes gjinore, ku komentuesit e quanin:

“Lavire, një lezbejk tinzare.”

Kjo fyerje përdor edhe paralele mizogjene edhe ato homofobike, duke përforcuar idenë se gratë që nuk pajtohen, veçanërisht nëse perceptohen se kanë identitete seksuale jokonformiste, janë në thelb të pabesa, të korruptuara moralisht dhe të papërshtatshme për të përfaqësuar vlerat "e vërteta" shqiptare.

Këta shembuj tregojnë se si gratë në jetën publike jo vetëm që fyhen, por syrgjynosen simbolikisht nga përkatësia kombëtare, ku feminiteti pranohet vetëm nëse është pasiv, modest dhe i heshtur.

Rasti i Edona Jamesit, figurë publike transgjinore, gjithashtu shkaktoi komente dehumanizuese, duke përfshirë komentet si:

“Kapne mar vrane.”

Kjo nuk është vetëm thirrje për dhunë, por refuzim i ekzistencës trans si identitet legjitim. Gratë transgjinore, veçanërisht ato në jetën publike, janë në cak si kërcënime simbolike për rendin moral të kombit që përfaqëson "dekadencën perëndimore" ose "erozionin e vlerave tradicionale shqiptare." Mospërputhja gjinore bëhet sinonim i tradhtisë ndaj identitetit kulturor.

Këta shembuj dëshmojnë se urrejtja gjinore nuk është e izoluar ose e rastësishme. Ajo është strukturore, sistematike dhe shpesh ndërsektoriale, duke lidhur gjininë, seksualitetin dhe përkatësinë politike në një logjikë më të gjerë të përjashtimit dhe delegitimimit. Zërat, trupat dhe zgjedhjet e grave policohen si pjesë e një lufte të vazhdueshme se kush duhet të përcaktojë dhe përfaqësojë kombin.

2. PAN ishte një koalicion politik në Kosovë i përbërë nga tre parti, PDK (Partia Demokratike e Kosovës), AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) dhe NISMA (Nisma Socialdemokrate), të cilat së bashku i kontestuan zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 me Ramush Haradinajn si kandidatin e tyre për kryeministër.

Fajësimi gjeopolitik dhe identiteti fetar

Lufta në Gaza shërbeu si shkas simbolik në disa narrativa. Në një rast, një burrë sulmoi verbalisht kryeministrin Albin Kurti gjatë një konference për shtyp duke iu referuar marrëdhënieve izraelito-palestineze:

“Aaah more i pa fe more pis more... shka je ti, se tkallxon Alahu...”

Shprehje të tilla shkrijnë zemërimin gjeopolitik me identifikimin fetar lokal, duke e përmbysur pozicionin politik të shtetit në tradhti të vlerave fetare.

Pas transmetimit të një dokumentari nga media online Insajderi mbi jetën e murgeshave katolike në Kosovë, dolën komente urrejtëse që targetonin murgeshat. Reportazhi, i cili përshkruante rutinat e përditshme të murgeshave, përkushtimin fetar dhe vendimin për të mbetur e pamartuar, shkaktoi reagim të ashpër në internet. Një koment thoshte:


“Kjo nuk është Fe po. Kjo te smundje Psiqike qe nuk te Len liri me jetu Jeten qysh ki qef.”

Reagime të tilla zbulojnë se si zgjedhjet fetare të grave, veçanërisht ato përtej pritshmërive mbizotëruese shoqërore, mund të bëhen cak i përbuzjes së publikut. Urrejtja e shprehur këtu nuk pasqyron mosmarrëveshje teologjike, por një shqetësim më të gjerë kulturor, ku gratë refuzojnë martesën dhe rolet tradicionale gjinore.

Analiza e sentimentit

Grupi i të dhënave u vlerësua duke përdorur një shkallë gjashtënivelëshe kodimi të sentimentit, ku 1-shi përfaqëson mospajtime të lehta e 6-shi përbën shprehjen më ekstreme (kërcënimet me vdekje). Rezultati mesatar i sentimentit në të gjitha incidentet në Kosovë ishte 3.10, që flet për një diskurs mesatarisht toksik.

Figura 4. Shpërndarja e sentimentit në incidentet e analizuara



Shpërndarja e niveleve të sentimentit

- > Sulmet me karakter negativ ishin forma më e zakonshme e sentimentit (78 raste), që përfshinin fyerje personale, poshtërim dhe delegjitimim.
- > Veprimet negative (16 raste) zakonisht përfshinin thirrje për përjashtim, kufizim ose dënim.
- > Dhuna eksplicite u shfaq në 15 raste, duke përfshirë kërcënime dhe justifikime të dëmtimit fizik.
- > Një numër i vogël rastesh përfshinin dëshira për vdekje (1 rast), gjuhë dehumanizuese (1 rast) dhe mospajtime të lehta (3 raste).

Kjo ndarje pasqyron një mjedis diskursi në të cilin dominon vrasja e karakterit, ndërsa nxitja e drejtpërdrejtë e dhunës mbetet prani aktive dhe shqetësuese.

Shembuj të gjuhës shumë toksike

- 1 “Veq spot shoh o i biri shkinës se besen e shqiptarit po ta jap se pat vra ty e do si ti se lo dije ditet e numrume i ki” – **Sentimenti 6 (Vdekje)**
- 2 “Qenat e shkins duhet mi rreh mire dajak” – **Sentimenti 5 (Dhunë)**
- 3 “Femra lavire që shiten më pare, degjenrimi femrav shqiptare nga kurva” – **Sentimenti 4 (Dehumanizimi)**

Retorika religjioze dhe mospajtimi simbolik

Udhëheqësit fetarë në Kosovë gjatë periudhës së monitorimit 2024-2025 paraqiten kryesisht në Incidentet e Nivelit 1, të karakterizuara nga mospajtimi simbolik ose ideologjik dhe jo nga nxitja e drejtpërdrejtë ose sulmet personale. R retorika e tyre, megjithëse nuk është e dhunshme në formë, shpesh përforcon kufijtë moralë dhe hierarkitë kulturore, sidomos rreth çështjeve të identitetit fetar, vlerave kombëtare dhe transformimit shoqëror.

Një rast i spikatur përfshiu imamin Fadil Musliu, i cili gjatë një ore fetare me fëmijë, parashtroi pyetjen:

“Si mund t’i bindni prindërit të mos e festojnë Vitin e Ri?”

Incidenti mori vëmendjen e publikut pasi xhamia postoi fotografi të fëmijëve dhe detaje të aktivitetit në faqen e saj zyrtare në Facebook. Ky postim shkaktoi reagime të konsiderueshme online dhe mbulim medial, ku kritikët, duke përfshirë sociologë dhe qytetarë, akuzonin iniciativën e indoktrinimit dhe keqpërdorimit të të miturve për qëllime ideologjike. Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) u distancua publikisht nga aktiviteti, duke e përshkruar atë si të paplanifikuar dhe të paautorizuar nga organet e saj qendrore, megjithëse imami lokal e mbrojti atë si pjesë të udhëzimeve të rregullta fetare.

Megjithëse e kornizuar si kritikë morale dhe jo si nxitje politike, ngjarja përpiquej t'i riformësonte normat kulturore përmes autoritetit fetar. Pasi u shpërnda përmes mediave sociale, ajo u bë pikë e kontestimit publik, duke treguar se si edhe mesazhet jo të dhunshme fetare mund të hyjnë në diskursin e polarizuar publik dhe të kontribuojnë në përvijimin e asaj që perceptohet si sjellje "e pastër" kulturore kundrejt asaj "të devijuar".

Megjithatë, në raste të tjera, figurat fetare eskaluan në narrativa me kornizim përjashtues ose ekzistencial, duke turbulluar vijën mes mospajtimit doktrinar dhe polarizimit shoqëror. Për shembull, Nusret Shiti, imami i Hanit të Elezit, dënoi publikisht Kodin Civil të propozuar të Kosovës që lejon bashkësitë mes të njëjtit seks, duke deklaruar:

“Ky kod është pro zhdukjes së species njeri.”

Ky kornizim refuzon pluralizmin ligjor, si dhe i konsideron të drejtat LGBTIQ+ si kërcënim qytetëror, duke mobilizuar frikën dhe panikun moral për të kundërshtuar reformat demokratike. Kjo deklaratë pasqyron një kallëp ku diskursi fetar përfshihet në inkuadrim biopolitik, duke përcaktuar se ekzistenca e kujt shihet si legjitime.

Një tjetër fije e tensionit simbolik që u vërejt gjatë periudhës së monitorimit ka të bëjë me rritjen e vizibilitetit fetar, sidomos praktikave islame si pelegrinazhi i haxhit, hixhabi dhe edukimi në xhami. Tradicionalisht, haxhi, pelegrinazhi vjetor në Mekë, ka zënë një vend të pranuar dhe të respektuar në peizazhin fetar të Kosovës. Megjithatë, diskursi i kohëve të fundit zbulon një jotolerancë të rritur ndaj shprehjeve të tilla të identitetit islam.

Në vitin 2025, disa media online raportuan për qytetarët e Kosovës që kryenin haxhin, të shoqëruar me imazhe dhe intervista të pelegrinëve. Rubrikat e komenteve të këtyre postimeve u mbushën shpejt me reagime armiqësore, duke përfshirë akuzat se pelegrinët e kthyer po "importonin kulturën arabe", "radikalizimin e të rinjve" dhe "riinterpretimin e Kur'anit në mënyra të papajtueshme me traditën shqiptare." Ajo që dikur konsiderohej detyrë fetare personale tani po kornizohet gjithnjë e më shumë si kërcënim për identitetin kombëtar ose kohezionin shoqëror. Ky reagim u drejtohet edhe aktorëve politikë islamë, dhe gjithnjë e më shumë targeton besimtarët e zakonshëm, veçanërisht gratë dhe vajzat që mbajnë hixhab, ose të rinjtë që ndjekin edukimin fetar në xhami. Një klerik, duke folur në televizion, deklaroi:

“Në çdo lagje në Kosovë do të hapim shkolla fetare, dhe askush nuk mund të na ndalojë.”

Ndërsa kjo mund të shprehë vendosmërinë fetare, reagimet publike shpesh i interpretuan deklaratat e tilla si konfirmime të fuqisë dhe shkelje të jetës laike, duke nxitur debat të polarizuar rreth rolit të islamit në edukimin publik.

Në fund, narrativat e konvertimit, sidomos ato që përfshijnë *Lëvizjen e Deçanit* kanë rritur paqëndrueshmërinë e diskursit fetar. Lëvizja, e themeluar vitin e kaluar, thuhet se përfshin dhjetëra individë që kanë hequr dorë nga islami, kanë përqafuar ateizmin, ose janë konvertuar në katolicizëm, duke pretenduar kthimin në besimin e tyre të lashtë dhe refuzim të asaj që ata e quajnë "islam radikal". Një pjesë e këtij grupi ka përmendur përdorimin e arabishtes në predikime, importimin e interpretimeve lindore të islamit, dhe udhëheqjen jolokale fetare si motivime kryesore për distancimin nga feja e tyre me të cilën kanë lindur.

Kalime të tilla kanë shkaktuar debate diskutabile online, ku ka pasur si narrativa mbështetëse ashtu edhe ato urrejtëse. Megjithatë, çështja themelore nuk është teologjia në vetvete, por kryqëzimi i identitetit fetar, përkatësisë kombëtare dhe frikës së zëvendësimit kulturor.

Megjithëse këta shembuj mbeten kryesisht brenda kufijve diskursivë jo të dhunshëm, ato kontribuojnë në një normalizim gradual të narrativave përjashtuese, shpesh të drejtuara ndaj individëve LGBTIQ+, grave, të konvertuarve dhe pakicave fetare. Ndërsa niveli i sentimentit mbetet i ulët, ngarkesa emocionale dhe potenciali i amplifikimit të këtyre mesazheve janë të konsiderueshme.

Udhëheqësit fetarë, për shkak të autoritetit të tyre të perceptuar moral, luajnë rol kyç në formësimin e normave të grupit, të cilat më vonë mund të radikalizohen ose të armatosen në mjedise më toksike (p.sh., rubrikat e komenteve në mediat sociale). Andaj, edhe incidentet e Nivelit 1 duhet të kuptohen si abetare kulturore, të afta për të thelluar ndarjet shoqërore përmes dhunës simbolike, nëse jo përmes agresionit ligjor ose fizik.

Figurat publike dhe të famshmit - Nivelet 3 dhe 5

Nga sulmet e karakterit të nxitjet e dhunës

Figurat publike, sidomos të famshmit dhe influencerët, shpesh dominojnë në rangun e mesëm dhe të sipërm të spektrit të urrejtjes, gjegjësisht Niveli 3 (Sulmet me karakter negativ) dhe Niveli 5 (Nxitja e dhunës). Këta individë shpesh shfrytëzojnë dukshmërinë dhe audiencën e tyre për të normalizuar fyerjet personale, për të delegjitimuar identitetet fetare ose seksuale dhe madje për të bërë kërcënime të nënkuptuara ose të qarta. Ndryshe nga qytetarët e rëndomtë, këto figura kanë fuqi amplifikuese, e cila e transformon edhe një postim ose deklaratë të vetme në një mesazh kulturor viral, që mund t'u japë formë qëndrimeve shoqërore.

Niveli 3 > Delegjitimimi i karakterit dhe poshtërimi simbolik

Një rast përfshin një figurë publike e cila, gjatë një paraqitjeje televizive, vuri në dyshim legjitimitetin fetar të një vendi adhurimi katolik:

“Nuk i them kishë. Objekt i Llapushnikut. Se ai është objekt i fesatit. Për fesat u nis. Fesat po bën.”

Kjo retorikë nuk thërret drejtpërdrejt për dhunë, por e zhvesh institucionin nga shenjtëria e tij dhe e cilëson si të papastër moralisht. Një delegjitimim i tillë simbolik gërryen bashkëjetesën fetare dhe vë themelet për përjashtimin shoqëror, veçanërisht në komunitetet me shumë besime si Kosova.

Një tjetër incident i Nivelit 3 ndodhi kur një imam i mirënjohur, duke dalë në një debat politik, e etiketoi *Lëvizjen e Deçanit*, lëvizje që përfshin konvertimet fetare publike dhe ateizmin, si një fenomen të dëmshëm:

“Kjo Lëvizja e Deçanit është ekstremiste. Nuk është në rregull me ia fy besimin dikujt tjetër.”

Megjithëse imami e paraqet veten si dënues të ekstremizmit, kornizimi i tij në mënyrë implicite e lidh konvertimin me radikalizmin, duke delegjitimuar kështu ndryshimin fetar dhe duke përforcuar nocionin se largimet publike nga islami janë devijime shoqërore.

Niveli 5 > Nxitja dhe kërcënimet për dhunë

Në nivelin më të ashpër të gjuhës së urrejtjes, shohim shembuj të figurave të famshme që bëjnë kërcënime të drejtpërdrejta të dhunës, sidomos kur përballen me kritikë publike ose në mbrojtje të nderit fetar. Në një rast veçanërisht alarmant, një reper i mirënjohur (Gold AG) përdori gjuhë fyese kundër gazetarit Vullnet Krasniqi gjatë një debati televiziv. Pas transmetimit dhe një postimi kritik në Facebook nga Krasniqi, ai mori kërcënime të përsëritura me vdekje nga individë në TikTok, gjë që çoi në një denoncim policor dhe reagim publik nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës.

“Mu’ s’mund te m’arrestoni, kurrë hiç, e 700 mijë vjet, harrojeni këtë... A Vullnet Krasniqi, ty të kam tregu se edhe sytë kam me t’i djegë cigare, mos gabo me dalë... Unë kam me ta q* f’miljen për Gold AG... Kur të më arrestoni ju Policia e Kosovës, unë ua jap dorë, ju thom hallall ju koftë... Vullnetin, kam me gjete, mbajeni në mend çka po ju thom, 16 copa kam me ja nje, rafall...”

Ky është incident i Nivelit 5, që përfshin kërcënime të drejtpërdrejta, eksplicite ndaj një gazetari, të rrënjosura në homofobi, mizogjini dhe hakmarrje personale. Gjuha është e ngarkuar emocionalisht, e dhunshme dhe e krijuar për të nxitur frikë, drejtpërdrejt te caku dhe te kushdo që mund të ketë identitete ose pikëpamje të ngjashme.

Deklarata të tilla nuk janë shpërthime të izoluar; ato janë shenjues kulturorë, të legjitimuar nga fama dhe të shpërndara gjerësisht nëpër platforma si Facebook dhe YouTube. Në këtë rast, statusi shoqëror i agresorit intensifikon kërcënimin, duke sinjalizuar se pandëshkueshmëria dhe e drejta mbrojnë gjuhën e urrejtjes kur shprehet nga të famshmit.

Është e rëndësishme të theksohet se gjetjet e këtij raporti formësohen nga përqendrimi metodologjik në incidente me përhapje të gjerë dhe ndikim të madh, shpesh duke përfshirë figura publike. Ndërsa kjo qasje kap efektet e amplifikuara të gjuhës së urrejtjes në sferën publike, ajo nuk merr parasysh raste më të përhapura ose me shikueshmëri të ulët që përfshijnë individë privatë. Kështu, predominimi i të famshmëve dhe influencerëve në këto të dhëna pasqyron shtrirjen e tyre mediale dhe jo ekskluzivitetin në prodhimin e gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, të dhënat konfirmojnë se figurat publike popullojnë në mënyrë disproporcionale nivelet e larta të toksicitetit, veçanërisht në poshtërimin e bazuar në karakter (Niveli 3) dhe nxitjen e dhunës (Niveli 5). Platforma e tyre publike amplifikon ngarkesën emocionale dhe simbolike të fjalëve të tyre, duke i shndërruar kërcënimet personale në validimin kulturor të jotolerancës.

Këta shembuj zbulojnë gjithashtu ndërthurjen e urrejtjes, ku mizogjinia, homofobia dhe delegjitimimi fetar shpesh ndërthuren në të njëjtin incident. Kjo e rrit dëmtimin e individëve të marginalizuar dhe normalizon narrativat binare 'në kundë atyre që dëmtojnë diskursin demokratik.

Kështu, të famshmit dhe influencerët duhet të shihen jo vetëm si argëtues, por si udhëheqës të opinionit, retorika e të cilëve mbart implikime serioze shoqërore, veçanërisht në një ekosistem të brishtë medial si ai i Kosovës, ku standardet redaktoriale dhe moderimi i përmbajtjes mbeten jokonsistente.

Nivelet 4-5: Dhuna me bazë gjinore dhe diskursi publik:

Nga heshtja institucionale në urrejtjen online

Tentativa e femicidit në Fushë Kosovë dhe femicidi në Gushtericë të Poshtme u raportuan gjerësisht nëpër media. Megjithatë, këto raste zbuluan gjithashtu çështje të thella në mënyrën se si dhuna ndaj grave përfaqësohet, diskutohet dhe, nganjëherë, trivializohet në diskursin publik të Kosovës, duke përfshirë vendimet redaktoriale, komentet në mediat sociale dhe mosveprimin institucional.

Niveli 4 > Shtrembërimi simbolik dhe kornizimi mizogjen

Në të dyja rastet, mbulimi medial shpesh përdorte gjuhë sensacionaliste, duke vënë në pah "dramën" e krimeve ndërsa minimizonte kontekstin sistematik. Titujt u jepnin hapësirë zërave të autorëve – siç tregon citimi i Idriz Aliajt:

“Unë sot nuk dua të përgjigjem më gjatë, vetëm dua t’ju tregoj se gjithçka që kam bërë sot me Sh.F e kam bërë me qëllim për ta vrarë.”

Ndërsa citimi pasqyron ashpërsinë e krimit, përsëritja e tij nëpër tituj i dha dukshmëri të panevojshme zërit të autorit të krimit, me kornizim ose paralajmërim minimal redaktorial. Vendime të tilla redaktoriale rrezikojnë të sensacionalizojnë dhunën dhe t'i traumatizojnë më tej viktimat dhe të mbijetuarit.

Për më tepër, pak media e kontekstualizuan deklaratën brenda dështimeve sistematike ose neglizhencës gjyqësore, edhe pse burri kishte shkelur një urdhër ndalimi dhe kishte precedent prej 38 veprash penale.

Niveli 5 > Thirrjet online për faj dhe përjashtim

Në rubrikat e komenteve online, veçanërisht nën postimet mediale në Facebook, faji zhvendosej drejt viktimave, ku kishte pohime të shpeshta se gratë e kishin "nxitur" dhunën ose kishin dështuar në rolet e tyre si partnere. Këto narrativa pasqyrojnë nxitjen e dhunës së Nivelit 5, pasi ato përfshinin justifikime të qarta të dhunës, kërcënime të mbuluara hollë dhe përpjekje për t'i përjashtuar moralisht gratë që shihen se nuk janë në përputhje me normat patriarkale. Këto komente rrallëherë moderoheshin ose hiqeshin.

Moderimi i dobët i gjuhës së urrejtjes në rubrikat e komenteve

Në rastin e vrasjes së Marija Zhivkoviqit nga burri i saj në Graçanicë, përgjigjja në të gjitha mediat kryesore ishte kryesisht faktike. Por, rubrikat e komenteve në faqet me trafik të lartë në Facebook dhe platformat online u karakterizuan me instanca shqetësuese të gjuhës së urrejtjes etnike dhe mizogjinisë, veçanërisht në faqen e Facebookut të *Gazetës Sinjali*.

Ndërsa shumica e platformave publikuan vetëm deklarata zyrtare të policisë ose prokurorisë, *Sinjali* mundësoi një bashkëbisedim të pafiltruar në të cilin përdoruesit postonin përmbajtje diskriminuese, duke përfshirë komente të tilla si:

Blerim Bela: “Bile një lajmi i mirë më n'diva se ky qita qetnik kan kanë mërre në qafë.”

Bessi Beqiri: “Shkau vret shkinen, një shkin më pak.”

Këto komente nxisin urrejtjen e bazuar në përkatësi etnike, ndërsa reflektojnë gjithashtu një normalizim shqetësues të dhunës gjinore dhe racore. Në veçanti, *Gazeta Sinjali*, e cila publikoi më shumë përmbajtje për femicidin se çdo media tjetër, nuk arriti t'i moderojë ose t'i heqë këto komente, pavarësisht shkeljes së qartë të udhëzimeve të komunitetit të Facebookut dhe kornizës ligjore të vetë Kosovës për nxitjen dhe gjuhën e urrejtjes.

Të dy rastet tregojnë se mbulimi medial i dhunës me bazë gjinore, kur nuk shoqërohet me kornizim të përgjegjshëm ose moderim të komenteve, mund të shërbejë si vektor për gjuhën e urrejtjes:

- > Fjalët e autorëve u cituan drejtpërdrejt dhe dukshëm, me ndjeshmëri minimale ndaj viktimave ose të mbijetuarve.
- > Rubrikat e komenteve, veçanërisht në Facebook, shpesh u bënë vatra të urrejtjes, me pak ose aspak ndërhyrje nga mediat.
- > Gjuha e urrejtjes në këto kontekste ishte ndërsektoriale, duke përzier sharjet etnike, mizogjininë dhe narrativat që fajësojnë viktimat.

Këto modele zbulojnë një hendek kritik në standardet redaktoriale dhe drejtimin e platformës, duke përforcuar nevojën për moderim të detyrueshëm të komenteve lidhur me përmbajtjen e dhunshme dhe trajnimin e gazetarëve për raportimin e traumave.

Analiza e vizibilitetit

Nga 114 incidente të regjistruara, 112 (98%) përfshinin një formë të të dhënave të mbulimit të audiencës (audience reach data), që tregon për një theks të fortë në potencialin e viralitetit dhe amplifikimit të narrativave të urrejtjes dhe dezinformimit në Kosovë.

Kanalet kryesore të shpërndarjes

Analiza e metadatave të lidhura me vizibilitetin zbulon se:

- X (ish-Twitter) ishte platforma më e përmendur në deklaratat e reach-it (29 incidente), pavarësisht bazës së saj relativisht më të vogël të përdoruesve në Kosovë.
- Portalet online (22 përmendje) luajtën rol të spikatur në publikimin ose ripublikimin e komenteve të mbushura me urrejtje.
- YouTube, Facebooku, dhe Instagrami u referencuan gjithashtu, megjithëse më rrallë në shënimet e mbulueshmërisë.

Shembuj ilustrues të mbulueshmërisë (reach)

Media	Platforma	Audience Reach
TV 10	Facebooku	309000
Gazeta Blic	Facebooku	479000
Portali Kossev	Facebooku	70000
RTV Dukagjini	YouTube	20000

Këto shifra tregojnë se shumë incidente të urrejtjes ndodhën në mjedise me mbulueshmëri të lartë, duke maksimizuar ndikimin e tyre të mundshëm në opinionin publik. Ndërsa Facebooku ishte platforma mbizotëruese në numërimin e papërpunuar të incidenteve (shih Grafikun 3), portalet dhe faqet e mediave televizive në YouTube ose X gjithashtu luajtën rol të madh në shtrirjen e narrativave nxitëse.

Ndërsa të dhënat e mbulueshmërisë ishin në dispozicion për shumicën dërrmuese të incidenteve, është thelbësore të merret parasysh efekti i amplifikimit të platformave me audiencë të madhe. Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes me toksitet të lartë (nivelet 4–6) u shfaq në kanalet me ndjekje të konsiderueshme, si faqet kryesore në Facebook, transmetimet në YouTube dhe portalet online, duke shtuar kështu dëmin e mundshëm dhe normalizimin e narrativave armiqësore brenda diskursit mainstream.

Analiza krahasimore

Kur shqyrtohet krahasimisht diskursi i urrejtjes dhe dezinformimit në Kosovë në vitet 2024-2025, shfaqen tre modele strukturore:

1 Dominimi i sulmeve të karakterit kundrejt kritikës institucionale

Krahasuar me raportet nga vendet fqinje (p.sh., Serbia ose Maqedonia e Veriut), diskursi i urrejtjes në Kosovë është shumë i personalizuar. Në vend se të kritikohen politikat ose institucionet, komentet publike shpesh sulmojnë tiparet individuale të identitetit, sidomos përkatësinë etnike, fenë ose gjininë. Kjo përputhet me pranimë dërmuese të rezultateve të sentimentit të *"karakterit negativ"* (78 nga 114 incidente).

2 Vijat etnike dhe fetare si vijat kryesore të fajit

Ndërsa vende si Shqipëria raportojnë nivele më të larta të dezinformimit në lidhje me qeverisjen ose manipulimin zgjedhor, narrativat e Kosovës janë më të polarizuara etnikisht dhe fetarisht. Kjo mund të shihet në veçanti te:

- a) Konflikti Izrael-Palestinë (i përdorur për t'i polarizuar udhëheqësit politikë),
- b) Mosmarrëveshjet e brendshme të lidhshpimit fetar,
- c) Përkujtimet e Luftës së Kosovës (p.sh., mohimi i masakrës së Reçakut).

3 Platformat e transmetimit: Facebooku

Ndryshe nga trendet e vëzhguara në disa rajone ku aplikacionet e koduara si [Telegrami](#) dhe platformat e drejtuara nga algoritme si TikTok janë shfaqur si vektorë kryesorë për dezinformim, diskursi i urrejtjes në Kosovë mbetet më i dukshëm dhe i qarkulluar gjithandej përmes platformave publike, veçanërisht [Facebookut](#) dhe portaleve të lajmeve. Këtë e konfirmojnë rezultatet e monitorimit të mediave që tregojnë se 106 nga 114 incidente të regjistruara të gjuhës së urrejtjes kanë ndodhur në Facebook, qoftë përmes faqeve personale ose llogarive të mediave, duke e bërë atë kanalin dominues për shpërndarje.



Veprimet parandaluese dhe ex-post për të luftuar urrejtjen dhe narrativat dezinformuese

Gjatë periudhës 2024–2025, në Kosovë pati përpjekje të kufizuara, por të shtuara të shoqërisë civile dhe institucionet që synonin luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit. Këto përgjigje shpesh ishin më shumë reaktive se preventive, dhe ndryshonin në fushëveprim, dukshmëri dhe efektivitet.

Përgjigjet institucionale

Agjencia e Kosovës për Informim dhe Privatësi lëshoi disa rikujtesa në lidhje me kufijtë etikë për raportimin medial, veçanërisht në rastet e dhunës gjinore dhe tensionit etnik. Megjithatë, sanksionet formale mbetën të rralla dhe mekanizmat e zbatimit të dobët. Këshilli i Mediave të Shkruara bëri paralajmërime në disa raste të rënda mediale, por nuk nxori udhëzime sistematike për urrejtjen online.

Iniciativat e shoqërisë civile

Krahasuar me ciklin e mëparshëm të monitorimit, shoqëria civile dhe aktivitetet institucionale në Kosovë fituan vizibilitet në vitin 2024, sidomos përmes iniciativave si ["Nisma e udhëhequr nga të rinjtë për të sfiduar gjuhën e urrejtjes"](#) e mbështetur nga UNFPA-UNDP e mbajtur në janar të vitit 2024. Kjo nismë bëri bashkë gazetarë me prejardhje të ndryshme etnike për t'iu kundërvënë narrativave përcarëse përmes rrëfimitarisë dhe angazhimit të mediave ndërkomunitare. Gjatë kësaj periudhe, OJQ-të si BIRN Kosova dhe Instituti D4D (Demokracia për Zhvillim) mbetën të angazhuara në mënyrë aktive në luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe forcimin e edukimit medial:

BIRN Kosova zbatoi projektin ["Promovimi i raportimit të bazuar në fakte dhe edukimit medial"](#) (tetor 2023 – qershor 2024). Kjo përfshiu punëtori në shkolla dhe trajnime për verifikimin e fakteve me gazetarë të rinj ndërkomunitarë, duke bashkëpunuar me KosSevin për të demaskuar dezinformimin dhe për të ndërtuar qëndrueshmëri te konsumuesit e mediave. [Instituti D4D](#) publikoi rezultate redaktoriale dhe hulumtuese gjatë gjithë vitit 2024 që bënë thirrje për vigjilencë më të madhe të qytetarëve dhe mendim kritik për të luftuar keqinformimin, veçanërisht si përgjigje ndaj polarizimit politik dhe etnik online. BIRN Kosova gjithashtu nxori një raport të ri të rëndësishëm prill të vitit 2025 të titulluar ["Gjuha e urrejtjes dhe dezinformimi gjatë zgjedhjeve të vitit 2025 në Kosovë"](#), i cili gjurmonte gjuhën e urrejtjes nga aktorët politikë gjatë fushatës parlamentare të shkurtit 2025 dhe avokonte për përmirësimin e mbikëqyrjes së mediave dhe llogaridhënies zgjedhore.

Megjithatë, masat rregulluese mbesin të mangëta dhe platformat mediale nuk i moderojnë vazhdimisht rubrikat e komenteve të përdoruesve, duke lejuar që gjuha nënçmuese e urrejtjes të përhapet pa u kontrolluar. Progresi gjithëpërfshirës në zbatimin e ligjit dhe moderimin e platformave është ende në pritje. Vlen të merret parasysh:

- > Moderimi i detyrueshëm ose filtrimi i automatizuar për tema me rrezik të lartë,
- > Paramoderimi i komenteve për storjet e ndjeshme,
- > Ose çaktivizimi i përkohshëm i komenteve ku përmbajtja e urrejtjes është mbizotëruese.

Përfundim

Peizazhi i urrejtjes dhe dezinformimit 2024-2025 në Kosovë paraqet një imazh të zyrtë të një shoqërie ende thellësisht të ndarë përgjatë linjave etnike, fetare dhe gjinore, ku mediat sociale shërbejnë si fushëbetejë dhe amplifikues i këtyre ndarjeve.

Nga ky monitorim dalin tre gjetjet kryesore:

1 Facebooku si epiqendra e diskursit të urrejtjes

Facebook dominon si në aspektin e vëllimit të incidenteve ashtu edhe në shtrirjen e amplifikimit. Me mbi 76 nga 114 incidente të lidhura me këtë platformë, ai është ekosistemi kryesor për urrejtje dhe keqinformim. Rubrikat e tij të komenteve, shpesh të pamenaxhuara, janë nikoqire të sulmeve kundër grupeve etnike, gazetarëve, grave dhe individëve LGBTQ+.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se kjo gjetje pasqyron fushëveprimin dhe dizajnin e monitorimit, i cili i dha përmbajtjes së qasshme publike në platformat mainstream. Ndërsa Facebook mundëson vëzhgimin e drejtpërdrejtë të komenteve dhe postimeve, platforma të tjera si Telegrami, TikTok ose aplikacione private të bisedave, nuk u monitoruan me të njëjtën thellësi ose mjete metodologjike, për shkak të natyrës së tyre të mbyllur ose gjysmë të mbyllur. Andaj, gjetjet nuk duhet të interpretohen si përfaqësim shterues i diskursit të urrejtjes në të gjitha platformat digjitale në Kosovë, por më tepër si një mostër treguese e rrënjës në sferat më të dukshme publike.

2 Narrativat e nxitura nga politika e identitetit dhe nxitësit historikë

Shumë incidente ishin të rrënjësura në kujtesën simbolike dhe ndërtimin e identitetit. Kjo u pa veçanërisht te nxitësit simbolikë siç është përvjetori i masakrës së Reçakut, që vazhdon të nxisë retorikë revizioniste ose mohuese. Më 15 janar 2024, duke shënuar 25-vjetorin e masakrës, deputeti serb Milovan Drecun përsëriti publikisht se "Reçaku nuk ishte masakër", por skenë e fabrikuar e inskenuar nga aktorë ndërkombëtarë. Përveç që ndezin tensione etnike, deklaratat e tilla legjitimojnë narrativat dezinformuese që i mohojnë mizoritë e kohës së luftës, duke mbështetur një mjedis diskursiv armiqësor veçanërisht në platformat e mediave sociale ku ato shpërndahen gjithandej.

“Drecun për Reçakun: E pakuptueshme që 25 vjet këmbëngulet që gënjeshtrojnë të paraqitet si e vërtetë.”

Gjuha e urrejtjes shpesh maskohet si retorikë patriotike, duke përdorur fenë ose përkatësinë etnike për t'i përshkruar mos pajtimet politike si tradhti.

Shembujt në vijim tregojnë se si logjika binare dhe dehumanizimi mbështesin shumë narrativa:

“Qenat e shkins duhet mi rreh”

“Femra lavire që shiten më pare, degjenrimi femrav shqiptare nga kurva.”

3 Parandalimi i dobët institucional

Përkundër përpjekjeve nga OSHC-të dhe disa institucioneve publike, nuk ka strategji nacionale kohezive për të adresuar urrejtjen ose dezinformimin online. Paralajmërimet rrallë kanë pasoja, e mungesa e rregullimit digjital krijon një mjedis tolerant ndaj shprehjeve toksike.

Ky raport konfirmon se urrejtja dhe dezinformimi nuk janë dukuri anësore në hapësirën digjitale të Kosovës, por ato janë sistematike, këmbëngulëse dhe emocionalisht të fuqishme. Adresimi i tyre do të kërkonte përpjekje të koordinuara në mbarë shoqërinë civile, platformat e teknologjisë, rregullatorët e mediave dhe sistemet arsimore. Deri atëherë, caqet, pakicat etnike, gratë, figurat fetare, kundërshtarët politikë, mbeten të cënueshëm karshi agresionit të koordinuar online.



RAPORTI I MONITORIMIT TË GJUHËS SË URREJTJES NË KOSOVË



Co-funded by
the European Union



Norway



**SMART
Balkans**
Civil Society for Shared Society
in the Western Balkans